



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
MINISTARSTVO OBRAZOVANJE I NAUKE
MINISTRY OF EDUCATION AND SCIENCE



INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS
PEDAGOSKI INSTITUT KOSOVA
KOSOVO PEDAGOGICAL INSTITUTE

Nr. prot: 45/26

Datë: 01.07.2026

Këshilli Drejtues i Institutit Pedagogjik të Kosovës (tutje referuar si, IPK), duke u bazuar në nenin 23 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 04/L-135 për Veprimtarin Kërkimore-Shkencore, në nenin 15 të Udhëzimit Administrativ 8/2017 të MASHT për Institutin Pedagogjik të Kosovës, nenit 33 të statutit të Institutit, si dhe procesverbalit në mbledhjen e mbajtur me datë 08.06.2026 merr këtë:

V E N D I M

1. **APROVOHET** hapja e thirrjes publike për angazhimin e dy ekspertëve të jashtëm për finalizimin e udhëzuesit dhe të programit të trajnimit për mësimdhënës.
2. Thirrja për angazhim do të jetë tërësisht publike dhe e hapur për të gjithë kandidatët potencialë që plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe specifike profesionale.
3. Procesi i shqyrtimit, vlerësimit të aplikacioneve dhe përzgjedhjes së kandidatëve do të realizohet nga një komision vlerësues i caktuar nga strukturat kompetente brenda institucionit.
4. Pas përfundimit të procedurave të shqyrtimit, u.d. Drejtori i Institutit do të nxjerrë vendim të veçantë për caktimin dhe emërimin e ekspertëve të përzgjedhur, të cilët do të ngarkohet me realizimin e detyrave sipas thirrjes.
5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

Arsyetim

Këshilli Drejtues, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 08.06.2026, në kuadër të pikës së tetë të rendit të ditës, shqyrtoi propozimin e z. Agim Bujari për angazhimin e dy ekspertëve të jashtëm me qëllim të finalizimit të udhëzuesit dhe programit të trajnimit për mësimdhënës.

Pas diskutimeve, anëtarët e Këshillit Drejtues vlerësuan se hapja e një thirrjeje publike garanton transparencë, konkurrencë të lirë dhe mundëson përzgjedhjen e profilit më të përshtatshëm profesional për këtë proces me rëndësi. Duke qenë se propozimi mori votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Anëtarëve të KD-së
2. Departamentit të Shërbimeve të përbashkëta

Kryesues / KD

Dr. Murteza Osdautaj